

PËRVOJAT E TË RRITURVE TË CILËT JANË PRINDËRUAR GJATË
ADOLESHENCËS

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCËS NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

nga

VIOLA PIREVA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË

Prishtinë

Korrik, 2026

Përvojat e të rriturve të cilët janë prindëruar gjatë adoleshencës

Kandidate: Viola Pireva

Mentore: Prof. Assoc. Kaltrina Kelmendi

Prindërit pritet të përmbushin nevojat themelore fizike dhe psikologjike të fëmijëve të tyre (Goldthorpe et al., 2019; Gutman & Feinstein, 2010; Maccoby, 2000). Megjithatë, në disa familje, fëmijët marrin role dhe përgjegjësi që zakonisht u takojnë prindërve. Ky fenomen njihet si prindërim dhe përkufizohet si një shtrembërim i hierarkisë familjare, ku fëmija merr role prindërore për të cilat nuk është i përgatitur në aspektin zhvillimor (Boszormenyi-Nagy & Spark, 1973; Minuchin et al., 1967). Prindërimi konsiderohet shkelje e kufijve gjeneracionalë dhe mund të ndikojë në zhvillimin emocional, personal dhe ndërpersonal të individit (Chase, 1999; Hooper, 2007a; Kerig, 2005).

Prindërimi manifestohet në dy forma kryesore: instrumental dhe emocional. Prindërimi instrumental përfshin marrjen përsipër të detyrave praktike, si kujdesi për motrat dhe vëllezërit, punët e shtëpisë apo mbështetja financiare, ndërsa prindërimi emocional nënkupton plotësimin e nevojave emocionale të prindërve, ndërmjetësimin e konflikteve dhe marrjen e rolit të personit të besuar (Greenberg & Jurkovic, 1999; Hooper et al., 2011). Literatura sugjeron se prindërimi emocional shoqërohet me pasoja më të theksuara psikologjike për shkak të barrës së tij emocionale që vendos mbi fëmijën (Borchet & Lewandowska-Walter, 2017).

Prindërimi lidhet me faktorë si sëmundjet fizike ose mendore të prindërve, përdorimi i substancave, konfliktet bashkëshortore, divorci, mungesa e njërit prind, vështirësitë ekonomike dhe transmetimi ndërgjeneracional i roleve jofunksionale (Barnett & Parker, 1998; Bifulco et al., 2014; Kerig, 2005). Gjithashtu, vajzat dhe fëmijët e parë në familje kanë më shumë gjasa të

përrjetojnë prindërim për shkak të pritjeve tradicionale gjinore dhe rolit të tyre në familje (Burnett et al., 2006; McMahon & Luthar, 2007; Schier et al., 2015).

Ndikimi i prindërimit nuk është gjithmonë homogjen. Në njëërën anë, prindërimi destruktiv lidhet me ankth, depresion, vështirësi në marrëdhënie ndërpersonale, pengim të zhvillimit të identitetit dhe probleme në funksionimin social e akademik (Hooper et al., 2011; Jones & Wells, 1996; McMahon & Luthar, 2007). Megjithatë, disa studime kanë identifikuar edhe rezultate pozitive, si zhvillimi i reziliencës, empatisë, përgjegjësisë dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve, sidomos kur përgjegjësitë kanë qenë të kufizuara dhe të mbështetura nga familja (Champion et al., 2009; Stein et al., 2007; Tompkins, 2007).

Megjithëse prindërimi është studiuar gjerësisht në literaturën ndërkombëtare, në kontekstin kosovar mungojnë studime empirike që eksplorojnë përvojat subjektive të individëve të prindëruar gjatë adoleshencës. Në një kulturë ku marrja e përgjegjësisë familjare në moshë të hershme shpesh konsiderohet normale, pasojat psikologjike të këtij fenomeni mund të mbeten të paidentifikuara. Ky hulumtim synon të plotësojë këtë boshllëk dhe të ofrojë njohuri të dobishme për profesionistët e shëndetit mendor dhe institucionet që punojnë me fëmijë dhe familje.

Hulumtimi mbështetet në Teorinë e Atashimit të Bowlby (1958) dhe Terapinë Strukturore Familjare të Minuchin (1974). Sipas Teorisë së Atashimit, marrëdhëniet e sigurta zhvillohen kur figura prindërore është emocionalisht e disponueshme, ndërsa prindërimi e cenon këtë proces duke e vendosur fëmijën në rolin e kujdestarit (Baggett et al., 2015; Hooper, 2007b). Nga ana tjetër, Terapia Strukturore Familjare e shpjegon prindërimin si pasojë të prishjes së kufijve ndërmjet nënsistemeve familjare dhe përmbysjes së hierarkisë prind-fëmijë (Demirtaş et al., 2025; Minuchin, 1974).

Hulumtimi përdori një qasje kualitative me dizajn eksplorues për të kuptuar përvojat subjektive të të rriturve që kanë qenë të prindëruar gjatë adoleshencës. Mostra përbëhej nga 10 pjesëmarrëse femra të moshës 19-32 vjeç, të përzgjedhura në mënyrë të qëllimshme përmes rrjeteve sociale dhe kontakteve personale. Të dhënat u mbledhën përmes intervistave gjysmë të strukturuar, të mbështetura në Parentification Questionnaire for Adults (PQ-A) (Sessions & Jurkovic, 1986) dhe Adult Attachment Interview (George et al., 1985), ku këto të fundit nuk janë administruar në format rigoroz standard, por janë përshtatur në format bashkëbisedimi, për qëllimet e hulumtimit. Intervistat u transkriptuan dhe u analizuan përmes analizës tematike sipas Braun dhe Clarke (2006).

Analiza tematike identifikoi nëntë tema kryesore: (1) roli i rendit të lindjes në prindërim; (2) përkujdesi instrumental dhe emocional; (3) përgjegjësitë si rezultat i presionit indirekt nga familja; (4) lidhja emocionale me prindërit; (5) mos-shpenzimi i kohës me shoqëri; (6) pjekuria dhe “rritja para kohës”; (7) periudha e prindërimit si periudhë stresuese dhe ngarkuese; (8) zgjidhja e problemeve si mënyrë e menaxhimit të konflikteve; dhe (9) reflektimi mbi përvojat e hershme dhe ndërtimi i forcës në të tashmen. Këto tema tregojnë se prindërimi është një përvojë komplekse me pasoja afatgjata në zhvillimin personal, emocional dhe ndërpersonal.

Në përgjigje të pyetjes së parë kërkimore, rezultatet treguan se shumica e pjesëmarrëseve kishin marrë njëkohësisht përgjegjësi instrumentale dhe emocionale, si kujdesi për motrat dhe vëllezërit, menaxhimi i punëve të shtëpisë dhe mbështetja emocionale për prindërit. Këto role zakonisht lindnin si pasoje e rrethanave familjare dhe ndjenjës së detyrimit, më shumë sesa nga kërkesat e drejtpërdrejta. Në lidhje me pyetjen e dytë, përvojat e hershme të atashimit vazhdonin të reflektoheshin në marrëdhëniet aktuale të pjesëmarrëseve përmes vështirësive në vendosjen e

kufijve, ndjenjës së përgjegjësisë së tepruar ndaj të tjerëve, hezitimit për të kërkuar ndihmë dhe frikës nga refuzimi ose braktisja. Këto gjetje mbështesin Teorinë e Atashimit, sipas së cilës mungesa e kujdesit të përshtatshëm në fëmijëri ndikon në marrëdhëniet në moshë madhore. Në përgjigje të pyetjes së tretë, pjesëmarrëset e përshkruan prindërimin si një përvojë me pasoja jo vetëm negative, por edhe pozitive. Përveç stresit dhe ngarkesës emocionale, ato raportuan zhvillim të pjekurisë së hershme, empatisë, ndjenjës së përgjegjësisë, reziliencës dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve, të cilat ndikuan edhe në mënyrën se si i qasen marrëdhënieve ndërpersonale dhe rolit të tyre profesional.

Ky hulumtim kishte disa kufizime. Mostra ishte e vogël dhe përbëhej vetëm nga pjesëmarrëse femra, duke kufizuar transferueshmërinë e gjetjeve dhe mundësinë e krahasimeve sipas gjinisë. Gjithashtu, të dhënat u bazuan në përshkrime retrospektive, të cilat mund të ndikohen nga kujtesa dhe interpretimet personale. Megjithatë si studim kualitativ, ky hulumtim nuk synon përgjithësimin e gjetjeve, por kuptimin e thelluar të përvojës subjektive të individëve.

Bazuar në këto rezultate, rekomandohet që hulumtimet e ardhshme të përfshijnë mostra më të mëdha dhe më të larmishme, si dhe hulumtime longitudinale për të kuptuar më mirë ndikimin afatgjatë të prindërimit. Në aspektin praktik, rezultatet theksojnë rëndësinë e identifikimit të hershëm të fëmijëve që marrin role të papërshtatshme kujdesi brenda familjes. Programet psikoedukative dhe ndërhyrjet familjare mund të ndihmojnë në forcimin e kufijve të shëndetshëm familjarë, përmirësimin e komunikimit dhe parandalimin e pasojave afatgjata të prindërimit.